REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 920/20
Datë/Datum. 18.11.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

IDA. Berat MARMULLAKU *Ekspert Shqyrtues Profesional / Teknik*	*Data e autorizimit të ekspertit* *13.11.2020*	*Data e dorëzimit të raportit* *18.11.2020*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: **11.11.2020**, operatori ekonomik **"MEGRANT ING " SH.P.K & "LUMEJTË HAVOLLI BLAKCORI" B.I – Prishtinë** , ka parashtruar ankesën me nr. **920/20**, kundër propozimit për dhënie të kontratës (Njoftimit mbi Vendimin e AK) ku është rekomanduar për kontratë: **"KADOLLI" SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari"** me nr. të prokurimit: **617-20-4196-4-2-3** dhe nr. te brendshëm: **617-2020-053-423**, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA SHTIME.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën: **Konkurs Projektimi**
Lloji i kontratës: **Konkurs i hapur**
Vlera e parashikuar e kontratës: **70,000.00 Euro.**

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:

- Njoftimi për konkurs te projektimit me datën 07.08.2020
- Procesverbali i Hapjes -koncept projekti është bërë me datën 28.08.2020
- Njoftim për rezultatet e Konkursit -Vendimi 04.09.2020
- Procesverbali i hapjes-elektronik (dokumentacioni -çmimi) 09.09.2020
- Vendimi i AK i datës 17.09.2020
- Njoftim për pezullim nga AK 22.09.2020
- Njoftim për pezullim, pas ankesës ne OSHP 28.09.2020

- Njoftim për rezultatet e Konkursit -Vendimi Rivlerësim 28.10.2020
- Njoftim për pezullim 02.11.2020
- Vendim aprovohet pjesërisht kërkesa 03.11.2020
- Njoftim për rezultatet -Vendimi 06.11.2020
- Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare 06.11.2020
- Lejimi i qasjes për datën 09.11.2020
- Ofrimi i dokumentacionit nga AK 09.11.2020
- Kërkesë për rishqyrtim 10.11.2020
- Njoftim për pezullim 10.11.2020
- Vendim Refuzim i kërkesës për rishqyrtim nga AK 11.11.2020
- Ankesë në OSHP 11.11.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Sa i përket pretendimeve të OE ankuesit:

Ne me datë 06.11.2020, ora 15;37 kemi kerkuar qasje ne dokumentet zyrtare te propozimeve te koncept projekteve te tenderit dhe AK na ka njoftuar se me datë pra 09.11.2020 ne ora 14:00 na mundesohet qasja ne dokumente zyrtare per kete aktivitet prokurimi dhe gjatë qasjes ne dokumente zyrtare ne kemi gjetur parregullsi gjatë rivlerësimit per kete aktivitet prokurimi dhe do ti paraqesim faktet si në vijim :

Pretendimi ankimor 1.
1. Propozimet e Koncept projekteve 0007 si dhe 2408 nuk i plotësojnë kushtet e dosjes së tenderit pasi qe gjatësia e bocetave te tyre është :
Propozim koncepti 0007 (i lartë 68 cm)
Propozim koncepti 2408 (i lartë 58 cm)

Dështmia 1.1
Koncept projekti me shifer 0007 i shpallur fitues pas rivleresimit është i lartë 68 cm ,dhe si i tillë duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm pasi nuk ka gjatësinë e kërkuar sipas DT Qëllimi i Konkursit të Projektimit 2.1

Qëllimi i Konkursit të Projektimit është si në vijim:
Realizimi i shtatores kushtuar Heroit Kombëtar Adem Jashari sipas kërkesave të specifikuara - Shprehja figurative artistike e shtatores duhet të integrohet fuqishëm dhe të korrespondojë vizuelisht me hapësirën e sheshit në të cilin planifikohet të vendoset figura në bronzë; -Shtatorja si koncept në vehte duhet të jetë shprehje artistike dhe figurative me të cilën kjartë reflekton tiparet dhe personalitetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari; -Shtatorja duhet të rrisë vlerën e sheshit dhe të vihen
në dukje elementet që shprehin vullnetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari; -Në konkurs pranohen punime individuale dhe grupore; -Punimi nuk duhet të jetë pjesëmarrës në ndonjë konkurs tjetër apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme të këtij lloji. Ai duhet të jetë i punuar enkas për

këtë konkurs. -Boceti i paraqitur nga konkuruesit si plastikë skulpturore duhet të jetë 60 cm i lartë, pa bazamentin; realizim kreativ-artistik që korospodon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siq janë portreti, duart, këmbët, veshja etj) Konkuruesit - Artistët kanë të drejtë që të marrin pjesë në konkurs vetëm me një punim; -Gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori fitues i konkursit, nëse e ndjen të nevojshme, mund të bëj ndryshime minore artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes kompozicionale me të cilën ka fituar konkursin, duke marrë pëlqimin paraprak të komisionit. Verejtje Variantet të cilat nuk respektojnë specifikat e vendosura - lartësia 60 cm, nuk do të merren parasysh, do të konsiderohen si konkurime të pa përgjegjshme. Fituesi i kontratës obligohet që brenda 100 ditëve kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës,ta sjell shtatoren dhe ta vendos në postament. Në çmim duhet të kalkulohen të gjitha shpenzimet punimi i bustit, transporti, sigurimi gjatë transportit dhe vendosja në postament, realizuesi i shtatores duhet të shenoj-Gaveroj edhe Emrin Mbiemrin,datën e lindjes dhe te vdekjes

PROVA NR 1 . MATJA E BOCETIT 0007



Dëshmia 1.2

Koncept projekti me shifer 2408 është i lartë 58 cm ,dhe si i tillë duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm pasi nuk ka gjatësinë e kërkuar sipas DT Qëllimi i Konkursit të Projektimit 2.1

Qëllimi i Konkursit të Projektimit është si në vijim:

Verejtje Variantet të cilat nuk respektojnë specifikat e vendosura - lartësia 60 cm, nuk do të merren parasysh, do të konsiderohen si konkurime të pa përgjegjshme.

PROVA NR 2 . MATJA E BOCETIT 2408



Pretendimi ankimor 2.

Dëshmia 2.1

Koncept projekti me shifer 0007 i shpallur fitues pas rivlerësimit ka shifren e shënuar në bocet 2000 dhe si i tillë ka marrë pjesë në ndonjë konkurs tjetër ,andaj duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm pasi nuk ka plotësuar kushtin e kërkuar sipas DT Qëllimi i Konkursit të Projektimit 2.1

Qëllimi i Konkursit të Projektimit është si në vijim:

- **Punimi nuk duhet të jetë pjesëmarrës në ndonjë konkurs tjetër apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme të këtij lloji. Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs.**

PROVA BOCETI :



Pretendimi ankimor 3.

Dëshmia 3.1

Koncept projekti me shifër 0007 i shpallur fitues pas rivlerësimit nga një komision me gjithsej 63.30 pike totale , me kete rast komisioni i rivlerësimit si dhe Autoriteti Kontraktues Komuna Shtime ka shkelur Ligjin e Prokurimit dhe nuk ka marre parasysh raportin e Ekspertit shqyrtues/teknik si dhe Vendimin e OSHP-së të datës 22.10.2020 per ankesën 730/20.

Autoriteti Kontraktues(Komuna Shtime) eshte pajtuar heren e pare me mendimin e ekspertit shqyrtues/teknik dhe ka kthyer lenden ne rivleresim (date 28.10.2020) dhe me kete rast propozimi i koncept projektit tonë **1955** eshte shpallur si propozim me piket maksimale pas ri-vleresimit dhe i cili ploteson te gjitha kushtet e DT dhe NJK.

Por pas kerkeses per rishqyrtim nga koncept projekti 0007 ,date 02.11.2020 çuditërisht Autoriteti Kontraktues Komuna Shtime ka formuar nje komision per te vleresuar per heren e tretë këtë konkurs te projektimit dhe me kete rast ka shkelur te gjitha vendimet dhe ka shperblyer me piket maksimale koncept projektin 0007 dhe me kete rast ka shkelur ligjin , duke shkelur keshtu mbi raportin e ekspertit shqyrtues/teknik dhe vendimin e OSHP-së të datës 22.10.2020 per ankesën 730/20 me të cilin eshte pajtuar edhe AK , ku ndër të tjera thotë :

KOMUNA SHTIME

NJOFTIMI PËR REZULTATET E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT-
REZULTATET E KONCEPT PROJEKTIT

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari-Ri-vlerësim

Nr. i Prokurimit 617-20-4196-4-2-3
Nr. i brendshëm 617-2020-053-423

Nr.	Kodi i Operatorit Ekonomik	Piket totale
1.	2408	0
2.	1955	69.6
3.	0007	28

Rezultati i aktivitetit te prokurimit, pas ri-vlerësimit :

Propozimi i koncept projektit që ka arritur rezultatin më të lartë, me pikë nga juria pas ri-vlerësimit është koncept projekti me kodin 1955

Propozimi i koncept projektit që ka arritur rezultatin e dytë me pikë nga juria pas ri-vlerësimit është koncept projekti me kodin 0007

Propozimi i koncept projektit që nuk ka hy në vlerësim është koncept projekti me kodin 2408

Koncept projekti me kodin 1955 dhe 0007 do te vazhdoj me vlerësim te përshtatshmërise teknike profesionale dhe me vlerësim te ofertës financiare, ndërsa koncept projekti me kodin 2408 nuk do te vazhdohet vlerësimi i mëtutjeshëm pasi që , Buceti i paraqitur nuk e plotëson kërkesen e specifikuar 60 cm i lartë pa bazament .Buceti i paraqitur nga OE me kodin 2408 është i lartë 58 cm pa bazament , dhe juria nuk e ka hy fare në vlerësim .Si dëshmi foto e Bucetit .

Data: 2 [illegible] 2020

Emri dhe mbiemri i ZRP: Nuredin Skeli

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, ne baze te nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.

PROVA 3. 1 Vendimi i OSHP-së:

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

730/20
22.10.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	22 TETOR 2020
REFERENCË:	730/20
PËR/ZA/TO:	AK- "KK Shtime"
NGA/OD/FROM:	Blerim Dina - Kryetar i OSHP-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM

Operatori ekonomik **"P.M.N." SH.P.K. - Prishtinë**, si palë e pakënaqur me datën: 28.09.2020, kanë parashtruar në OSHP ankesën me numër 730/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari" me nr. të prokurimit: 617-20-4196-4-2-3 dhe nr. te brendshëm: 617-2020-053-423**, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 6, 7, 59, 60 dhe 80 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 09 TETOR 2020 kanë autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti profesional i prokurimit me datën 19.10.2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht te anulohet propozimi për dhënie te kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në RIVLERËSIM.**

Autoriteti kontraktues- **"KK Shtime"** me datën 20 Tetor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit profesional të prokurimit dhe të njëjtit me datën 21 Tetor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues **"P.M.N." SH.P.K. - Prishtinë** me datën 20 Tetor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit profesional te prokurimit dhe të njëjtit me datën 21 Tetor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues - **"KK Shtime"** për aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari"** me nr. të prokurimit: **617-20-4196-4-2-3** dhe nr. te brendshëm: **617-2020-053-423** dhe njëkohësisht kanë konstatuar se e OE ankues te **të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht te anulohet propozimi për dhënie te kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në RIVLERËSIM**, konform konstatimeve dhëna ne raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik **"P.M.N." SH.P.K. - Prishtinë** konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

PROVA 3.2 Raporti i ekspertit shqyrtues IDA Berat Marmullaku :

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr./Br. 730120
Data/Datum 19.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

IDA. Berat MARMULLAKU *Ekspert Shqyrtues Profesional / Teknik*	*Data e autorizimit të ekspertit* *09.10.2020*	*Data e dorëzimit të raportit* *19.10.2020*

Bazuar ne Qëllimin e Konkursit të Projektimit, si dhe duke marre parasysh se kemi te bëjmë me shtatoren e Heroit Kombëtar Adem Jashari, si Ekspert Shqyrtues pa dashur te kontestoj profesionalizmin e anëtareve te jurisë, por me qëllimin me fisnik te vlerësimit sa me te drejtë, nga këndvështrimi im profesional nuk pajtohem me përzgjedhjen e bocetit me shifrën 0007 krahasuar me dy modelet tjera 2408 dhe 1955.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **OE "P.M.N." SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari"** me nr. të prokurimit: 617-20-4196-4-2-3 dhe nr. te brendshëm: 617-2020-053-423, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA SHTIME.**

Bazuar ne detyrën projektuese, ku nder te tjera potencohet se: **realizim kreativ-artistik që korospodon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siq janë portreti, duart, këmbët, veshja etj)** , boceti i përzgjedhur nga AK nuk i plotëson parametrat e kërkuara ne detyrën projektuese, nuk i ka tiparet faciale te Heroit Kombëtar Adem Jashari, por me shume ngjason me ndonjë hero tjetër te para një shekulli, si p.sh. Qerqiz Topulli, etj.

Ky model i përzgjedhur nga AK nuk asocon me Heroit Kombëtar Adem Jashari, nuk paraqet një model reprezentativ te figurës se Adem Jasharit, nuk shprehë butësinë dhe fisnikërinë qe duhet ta këtë, qe ti rezistoj kohës dhe të jetë monument i pëlqyer edhe nga gjeneratat e reja qe do vinë.

Bazuar ne tre modelet e prezantuara ne këtë konkurs projektimi, nga këndvështrimi im konsideroj se nuk është bërë përzgjedhja e duhur, se ky model nuk e ritë vlerën e sheshit krahasuar me dy modelet tjera.

Bazuar ne çka u tha me lartë, **Eksperti Shqyrtues** konsideron se ky Aktivitet i Prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim dhe AK në bazë të kompetencave të tyre të vazhdojë procesin e rivlerësimit konform LPP-së dhe RRUOPP-së, duke i marre për bazë ne mënyrë te drejtë nën kriteret e tenderit si dhe detyrën projektuese te kërkuar ne NJKP dhe DT.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht te anulohet propozimi për dhënie te kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në RIVLERËSIM.

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka shkelur **Ligjin e Prokurimit Publik** , gjegjësisht
RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK
neni 41 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

41.1 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga OE do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i epet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë procedurës së prokurimit. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri-vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigjojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHPsë përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar.
Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë , kërkojmë nga Ju si AK që të aprovoni kërkesën tonë për rishqyrtim :

VENDIM

APROVOHET ,si e bazuar ankesa e OE:

Megrant Ing SH.P.K & Lumjet Havolli Blakqori B.I

lidhur me konkursin e projktimit **Ndertimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari**

ANULOHET , VENDIMI mbi rezultatet e konkursit te projektimit datë 06.11.2020

OBLIGOHET, Komuna Shtime të kthejë lëndën në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit të veprojë sipas vendimit të OSHP-së nr. 730/20 datë 22.10.2020

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankuesit:

Nenet: 6, 7, 10, 51, 56, 57, 59 ,60, 65 dhe 70 te LPP si dhe RROUP 41.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Nen kriteret e Konkursit te Projektimi sipas Dosjes se Tenderit

	Nën-kriteret	**Pesha në %**
1	1.Kompozicioni artistik i shtatores.	**40%**
2	2.Shprehja figurative me te cilen reflektohen e tiparet dhe personalitetin e Heroit Kombëtar Adem Jashari.	**10%**
3	3.Shkalla e integrimit të shtatores në hapësir ku planifikohet të vendoset (Të preznetohen 3D pamja nga minimun 3 kënde të ndryshme).	**10%**
4	4.Origjinaliteti.	**10%**
5	5.Çmimi	**30%**
	Proporcioni i vlersimit 70% pikë teknike- zgjidhja artisitke , 30% çmimi. Pikët llogriten duke marr për bazë pikët artisitike dhe çmimi	

Ofertat me çmime sipas procesverbalit te hapjes se tenderit.

Radhë	Lenda / grupi: Ndërtimi i Shtatores së Komandantit Adem Jashari	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	N.N.P. "KADOLLI" SHPK, 60016092	68 500,00
2.	Lumjetë Havolli Blakçori B.I., 810050823	69 900,00
3.	P.M.N. SH.P.K., 810800856	69 985,00

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Autoriteti Kontraktues me datën 28.10.2020 publikon Njoftimin për Rezultatet e Konkursit te Projektimit - Rezultatet e Koncept Projektit sipas ri-vlerësimit te parë nga Komisioni i Ri-vlerësimit:

Nr.	Kodi i Operatorit Ekonomik	Piket totale
1.	2408	0
2.	1955	69.6
3.	0007	28

Rezultati i aktivitetit te prokurimit, pas ri-vlerësimit :

Propozimi i koncept projektit që ka arritur rezultatin më të lartë, me pikë nga juria pas ri-vlerësimit është koncept projekti me kodin 1955

Propozimi i koncept projektit që ka arritur rezultatin e dytë me pikë nga juria pas ri-vlerësimit është koncept projekti me kodin 0007

Propozimi i koncept projektit që nuk ka hy në vlerësim është koncept projekti me kodin 2408

Koncept projekti me kodin 1955 dhe 0007 do te vazhdoj me vlerësim te përshtatshmërise teknike profesionale dhe me vlerësim te ofertës financiare, ndërsa koncept projekti me kodin 2408 nuk do te vazhdohet vlerësimi i mëtutjeshëm pasi që , Buceti i paraqitur nuk e plotëson kërkesen e specifikuar 60 cm i lartë pa bazament .Buceti i paraqitur nga OE me kodin 2408 është i lartë 58 cm pa bazament , dhe juria nuk e ka hy fare në vlerësim .Si dëshmi foto e Bucetit .

Autoriteti Kontraktues me datën 06.11.2020 publikon Njoftimin për Rezultatet e Konkursit te Projektimit - Rezultatet e Koncept Projektit sipas ri-vlerësimit nga Komisioni i Ri-vlerësimit:

Nr.	Kodi i Operatorit Ekonomik	Piket totale
1.	2408	23.30
2.	1955	31.30
3.	0007	63.30

Rezultati i aktivitetit te prokurimit, pas ri-vlerësimit :

Propozimi i koncept projektit që ka arritur rezultatin më të lartë, me pikë nga juria pas ri-vlerësimit është koncept projekti me kodin 0007

Propozimi i koncept projektit që ka arritur rezultatin e dytë me pikë nga juria pas ri-vlerësimit është koncept projekti me kodin 1955

Propozimi i koncept projektit që ka arritur rezultatin e tretë me pikë nga juria pas ri-vlerësimit është koncept projekti me kodin 2408

Pikëve të vlersimit të koncept projektit , do të ju shtohen edhe piket e vlersimit të ofertës financiare dhe përshtatshmëria teknike profesionale. Pjesëmarrësit në këtë konkurs të projektimit që nuk i plotësojnë kriterte e përcaktuara nga AK , sipas dosjes së tenderit dhe konkursit të projektimit , do të eliminohen nga gara e këtij konkursi .

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP-se nr. 730/20 i datës 22.10.2020

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

/

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Përgjigje në Pretendimet ankimore (neni 113 i LPP-së) të OE ankues:

Pretendimi ankimor 1.

1. Propozimet e Koncept projekteve 0007 si dhe 2408 nuk i plotësojnë kushtet e dosjes së tenderit pasi qe gjatësia e bocetave te tyre është : Propozim koncepti 0007 (i lartë 68 cm)
Propozim koncepti 2408 (i lartë 58 cm)

Dështmia 1.1

Koncept projekti me shifer 0007 i shpallur fitues pas rivleresimit është i lartë 68 cm ,dhe si i tillë duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm pasi nuk ka gjatësinë e kërkuar sipas DT Qëllimi i Konkursit të Projektimit 2.1

Eksperti shqyrtues/teknik këtë pretendim të OE ankues e konsideron si **te pa bazuar**. Boceti 0007 i ofruar nga OE i rekomanduar e plotëson gjatësinë e kërkuar prej 60 cm, duke marre parasysh përshkrimin e konkursit te projektimit (Detyrën Projektuese) ne NJKP dhe DT, është e theksuar se: **Boceti i paraqitur nga konkuruesit si plastikë skulpturore duhet të jetë 60 cm i lartë, pa bazamentin.** – dhe lartësia prej 68 cm është gjatësia nga dyshemeja (me gjithë bazament).

Dështmia 1.2

Koncept projekti me shifer 2408 është i lartë 58 cm ,dhe si i tillë duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm pasi nuk ka gjatësinë e kërkuar sipas DT Qëllimi i Konkursit të Projektimit 2.1

Eksperti shqyrtues/teknik këtë pretendim të OE ankues e konsideron **te bazuar**, boceti 2408 nuk e plotëson gjatësinë e kërkuar ne Dosje te Tenderit prej 60 cm.

Pretendimi ankimor 2.

Dështmia 2.1

Koncept projekti me shifer 0007 i shpallur fitues pas rivlerësimit ka shifren e shënuar në bocet 2000 dhe si i tillë ka marrë pjesë në ndonjë konkurs tjetër ,andaj duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm pasi nuk ka plotësuar kushtin e kërkuar sipas DT Qëllimi i Konkursit të Projektimit 2.1

Eksperti shqyrtues/teknik këtë pretendim të OE ankues e konsideron si **te bazuar**, boceti i ofruar nga OE i rekomanduar ka shifrën 2000, ndërsa ne tender ka ofertuar me shifrën 0007. Bazuar ne përshkrimin e konkursit te projektimit (Detyrën Projektuese) ne NJKP dhe DT, është e theksuar se: **Punimi nuk duhet të jetë pjesëmarrës në ndonjë konkurs tjetër apo të jetë ekspozuar në veprimtari të tjera të mëparshme të këtij lloji. Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs.** Boceti me shifrën 2000 i OE te rekomanduar nuk përputhet me ofertën e tije ku e mban shifrën 0007, ose mund te jete bocet i punuar për ndonjë konkurs tjetër, me ç'rast bie ndesh me kërkesën e DT - **Ai duhet të jetë i punuar enkas për këtë konkurs.**

Pretendimi ankimor 3.

Eksperti shqyrtues/teknik këtë pretendim të OE ankues e konsideron si **te bazuar**, dhe është i pa kuptueshëm dallimi rrënjësore ne mes rivlerësimit te parë dhe te dytë, ku pas vendimit te dhënë nga OSHP-se nr. 730/20 te datës 22.10.2020, behet vlerësimi i datës 28.10.2020 dhe modeli 0007 vlerësohet me 28 pike kundrejt modelit 1955 qe vlerësohet me 69.6. Ndërsa me rivlerësimin e datës 06.11.2020 modeli 0007 vlerësohet me 63.30 pike kundrejt modelit 1955 qe vlerësohet me 31.30.

Autoriteti Kontraktues (Komuna Shtime) ne këtë rast i përbishtnon ekspertizës nr. 730/20 te datës 19.10.2020 dhe vendimit te OSHP-se nr. 730/20 te datës 22.10.2020, ku edhe pse pajtohet me konstatimet e ekspertizës, përsëri vepron ne mënyrën e njëjtë sikur herën e parë.

Ne përgjigjen e datës 21.10.2020, AK - Komuna Shtime thekson se:

Pas pranimit të shkresës së mendimit të ekspertit shqyrtues për projektin,, Ndërtimi i Shtatores së Heroit Adem Jashari ,, ne si AK kemi analizuar me kujdes mendimin e ekspertit shqyrtues , dhe pajtohemi me mendimin e tij .

AK Komuna e Shtimes do të themeloj një juri tjeter profesionale për vlersimin e koncept projetit .

Është i bazuar pretendimi se pas kërkesës për rishqyrtim nga OE i rekomanduar me koncept projektin 0007, AK - Komuna Shtime ka formuar një komision për te vlerësuar për herën e tretë këtë konkurs te projektimit dhe me këtë rast ka shkelur te gjitha vendimet paraprake dhe ka shpërblyer me piket maksimale koncept projektin 0007, duke shkelur kështu mbi raportin e ekspertizës te dt. 19.10.2020 dhe vendimin e OSHP-së nr. 730/20 të datës 22.10.2020 me të cilat është pajtuar paraprakishtë.

Bazuar ne Qëllimin e Konkursit të Projektimit, si dhe duke marre parasysh se kemi te bëjmë me shtatoren e Heroit Kombëtar Adem Jashari, si Ekspert Shqyrtues pa dashur te kontestoj profesionalizmin e anëtareve te jurisë, por me qëllimin me fisnik te vlerësimit sa me te drejtë, dhe duke marre parasysh se është hera e dyte e shqyrtimit te lendes se njëjtë ne OSHP, nga këndvështrimi im profesional nuk pajtohem me përzgjedhjen e bocetit me shifrën 0007 (respektivisht sipas bocetit 2000) krahasuar me modelin e OE ankues 1955.

Krahasimi i dy modeleve ne konkurrence:



0007

1955

Bazuar ne detyrën projektuese, ku nder te tjera potencohet se: **realizim kreativ-artistik që korospodon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siq janë portreti, duart, këmbët, veshja etj)** , boceti i përzgjedhur nga AK nuk i plotëson parametrat e kërkuara ne detyrën projektuese, nuk i ka tiparet faciale te Heroit Kombëtar Adem Jashari, por me shume ngjason me ndonjë hero tjetër te para një shekulli, si p.sh. Qerqiz Topulli, etj.

Ky model i përzgjedhur nga AK nuk asocon me Heroit Kombëtar Adem Jashari, nuk paraqet një model reprezentativ te figurës se Adem Jasharit, nuk shprehë butësinë dhe fisnikërinë e nje figure heroike te historisë krahasuar me modelin 1955.

Boceti nr. 1955 i ofruar nga OE ankues, është modeli me i qëlluar, me reprezentativ, me imazhin me fisnik te Heroit Kombëtar Adem Jashari, nga tre modelet ne këtë tender.

Duke marre parasysh se kemi te bëjmë me shtatoren e Heroit Kombëtar Adem Jashari, me përgjegjësi profesionale mund te konstatoj se Modeli 1955 i OE ankues, pa asnjë dyshim është modeli me i arritur ne këtë konkurs projektimi, si për nga aspekti artistik, monumental, vizionar, reprezentativ, realizimi me kreativ-artistik që korospodon me kohën që nga pozicionimi dhe ndërtimi i figurës e deri në detajet e modelimit, siq janë portreti, duart, këmbët, veshja etj).

Modeli 1955 i OE ankues integrohet fuqishëm dhe të korrespondojë vizuelisht me hapësirën e sheshit, kjo shtatore do ta rrisë vlerën e sheshit, dhe gjatë realizimit të veprës në madhësi reale, autori i këtij boceti, siç është lejuar ne detyrën projektuese te këtij Konkursi të Projektimit: **nëse është e nevojshme, mund të bëj ndryshime minore, artistike por që nuk shkojnë përtej zgjidhjes kompozicionale me të cilën ka fituar konkursin.**

Modeli 1955 i OE ankues, pa asnjë dyshim është modeli me i mirë, është modeli me meritor për shpërblim me kontrate ne këtë konkurs projektimi, model qe do ti rezistoj kohës dhe do të jetë monument i pëlqyer edhe nga gjeneratat e reja qe do vinë, model qe reflekton fisnikërinë, ndërgjegjësimin dhe vendosmërinë.

Bazuar ne ça u tha me lartë, **Eksperti Shqyrtues** konsideron se ky Aktivitet i Prokurimit duhet të kthehet në rivlerësim dhe AK në bazë të kompetencave të tyre të vazhdojë procesin e rivlerësimit konform LPP-së dhe RRUOPP-së, detyrës projektuese te kërkuar ne NJKP dhe DT, te obligohet AK qe ti marre për bazë konstatimet profesionale te cekura ne këtë ekspertizë.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, rrjedhimisht te anulohet propozimi për dhënie te kontratës (Njoftimi mbi Vendimin e AK) dhe Aktiviteti i Prokurimit te kthehet në RIVLERËSIM.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SHTIME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"MEGRANT ING " SH.P.K & "LUMEJTË HAVOLLI BLAKCORI" B.I.,**